



Punëtori për kontabilistët anëtarë të SHPM

Edukim për punë financiare

Punëtorinë e hapi kryetari i SHPM Dragi Argirovski, i cili së pari foli për arritjet e Shoqatës në vitin jubilar 2016, dhe më pas për domethënien e edukimit të kontabilistëve për punë adekuate financiare



Në restorantin "Panini" në Liqenin e Velesit, më 6 shkurt të vitit 2017 u mbajt punëtori për përpunimin e raportit financiar dhe llogarisë vjetore për shoqatat e pensionistëve anëtarë të Shoqatës, ku morën pjesë kontabilistë, kryetarë të shoqatave dhe kryetarë të Bordit Mbikëqyrës, gjegjësisht 80 pensionistë dhe 28 shoqata. Punëtorinë e hapi kryetari i SHPM Dragi Argirovski, i cili mes tjerash së pari foli për arritjet e Shoqatës në vitin jubilar 2016, dhe më pas për domethënien e edukimit të kontabilistëve për punë adekuate dhe të ligjshme financiare, e cila është treguar

shumë e dobishme dhe është vërtetuar në praktik në pesë vitet e kaluara.

"Falë këtij edukimi dhe përgatitjes së kontabilistëve dhe kryetarëve të KM për punë ligjore, në kuadër të Shoqatës në periudhën e kaluar nuk janë konstatuar dobësi dhe kushte të pafavorshme nga autoritetet e inspektimit dhe të mbikëqyrjes as në shoqatë e as në Unionin. Pas materialit, foli edhe recenzi i udhëzuesit Mitre Stojanovski, i cili

theksoi se i njëjti është i qartë dhe profesional me shumë shembuj dhe do t'ju ndihmojë konstabilistëve të shoqatave anëtarë të SHPM më lehtë të bëjnë llogaritë përfundimtare për vitin 2016. Autori i Udhëzuesit Romeo Kostadinov, përmendi të gjitha çështjet më me rëndësi në lidhje me këtë problematikë. Ai përmendi problemet që mund të paraqiten në raste të ndryshme dhe që shkaktojnë pasojë nëse nuk trajtohen

sipas rregullave të përcaktuara dhe rekomandimet ligjore. Në fillim të pjesës së dytë të punëtorisë pjesëmarrësve i'u drejtua kryetari i Kuvendit Besnik Poca dhe nënkryetari i KE Salltir Karovski, të cilët folën për rëndësinë e shtëpisë dhe punën transparente të shoqatës. Më pas u zhvillua bisedë e gjërë dhe e frytshme, ku të pranishmit parashtruan pyetje, ndërsa autori i udhëzuesit përgjigjej.

SHP Dibër dhe Qendra Zhupa Interesim i madh për banjë falas

Në Njësinë e Biznesit të Fondit Pensional dhe invalidor thonë se për pesë ditë jo të plota nga publikimi i lajmërimit kanë aplikuar tridhjetë pensionistë, kryesisht për rekreacion klimatik - banjë falas. "Interesim i madh mbizotëron në mesin e pensionistëve të komunave Dibër dhe Qendër Zhupë për shfrytëzimin e dobive, të cilat i ofron projekti qeveritar për rekreacion klimatik falas në banjë dhe vikend turistik falas", thuhet në vlerësimin që e Njësisë së Biznesit të Fondit Pensional dhe invalidor në Dibër, e cila në aktivitetin e saj i përfshinë të dy komunat. Aplikimi në këtë dobi filloi më 20 janar dhe zgjati deri 20 shkurt të këtij viti. Në rekreacionin klimatik falas në banjë, në gjashtë vitet e kaluara kanë qenë 340 pensionistë nga komunat Dibër dhe Qendër Zhupë, ndërsa në dy vitet e kaluara në vikend turistik kanë qenë 44 pensionistë. Pensionistët nga SHP Dibër dhe Qendër Zhupë të drejtën për banjë falas e realizojnë më shumë në Banjat e Dibrës-Capa, bashkë me pensionistët nga komunat në rajonin jug-perëndimor të vendit. Ata janë shumë të kënaqur nga përfitimti, por edhe nga komodimi dhe shërbimi të cilën e ofrojnë banjat, si dhe nga personeli i sjellshëm dhe profesional. Vikendin turistik e kalojnë në njërin nga hotelet përgjatë liqenit të Ohrit dhe Prespës.



Pensionistët e Kumanovës

Natë zbavitëse dhe sportive

Nën organizimin e SHP Kumanovë, më 29 dhjetor të vitit 2016 në restorantin "Gracija" u mbajt nata tradicionale zbavitëse sportive, ku u shpallën sportistët individual më të mirë dhe u festuan arritjet e vitit 2016. Pjesëmarrësve ju drejtua drejtori SHP Kumanovë Spiro Nikollovski, duke i theksuar sukseset e shoqatës të gjithëve ju uroi festat e fundvitit dhe Krishtlindjet. Falënderim të veçantë për sportistët të cilët arritën rezultate të jashtëzakonshme në Olimpiadën pensionistëve në Radovisht. Në takim folën edhe kryetarët e komunave të Kumanovës dhe



Nagoriçanit të Vjetër, Zoran Damjanovski dhe Millovan Stojkovski, të cilët u koncentruan te bashkëpunimi i Shoqatës me pushtetin lokal, dhe më pas u betuan për mbështetje më të madhe në aktivitetet e vitit të ardhshëm. Për rezultatet e sportistëve në

vitin 2016 foli sekretari i SHP Kumanovë, Jovica Vançevski. Për sportist më i mirë u shpall Blazho Stanojkov, fitues i medaljes së artë për hedhje, ndërsa në konkurrencën e meshkujve si ekip më i mirë u shpall ekipi për penallti në gollë të vogla në përbërje të:

Dragan Panovski, Jovica Stojčevski, Vojçe Krstevski i Banko Milenkovski. Njohje fituan dhe Jasmina Todorovska, fituese medalje argjend në vrapim të 60 metra, Stojna Velkovikj, fituese e argjendit në domino, Mirko Cvetkovski-trajneri më i suksesshëm në atletikë, si dhe Janinka Kostadinovska, konkurrenente më e moshuar në shah. Për kujtim u bë një fotografi e përbashkët, me çka ahengu vazhdoi në atmosferë të këndshme, me muzikë dhe lojë, me shpresë që viti tjetër të jetë më mirë, më i suksesshëm dhe më i lumtur për të gjithë.

22 vite me "Ëmbëlsirat e gjyshes"

Manifestimi kishte karakter multietnik. Fillimisht të pranishmit i përshëndeti kryetarja e Aktiveve të pensionistëve nga SHP Veles, Bllagojka Nastova

Më 10 shkurt të vitit 2017, për herë të 22 u mbajt manifestimi tradicional "Ëmbëlsirat e gjyshes" në Veles. Nikoqir ishte SHP Veles, ndërsa morën pjesë shumë pensionistë nga SHP Shtip dhe Karbinci, SHP Negotinë, SHP Kavadar, SHP Tetovë, SHP Strugë, SHP Prilep, SHP Lozovë dhe SHP Shën Nikollë. Manifestimi kishte karakter multietnik. Fillimisht të pranishmit i përshëndeti kryetarja

ja e Aktiveve të pensionistëve nga SHP Veles, Bllagojka Nastova. Mysafirët i përshëndeti dhe ju drejtua edhe kryetari i SHP Veles, dr. Vele Aleksoski. Gjithashtu, mysafirët i përshëndeti dhe kryetari i Komunës së Velesit, Sllavčo Čadiev. "Gëzohem që e ruajmë traditën, sepse me ruajtjen e trashëgimisë kulturore, është ruajtur ekzistenca e kombit maqedonas dhe të gjithë atyre të cilët jetojnë në këtë vend. Komuna gjithmonë është në dispozicionin tuaj, që t'ju mbështet dhe t'i mbështet aktivitetet tuaja", tha ai.

Manifestimin e hapi kryetari i SHPM, Dragi Argirovski, i cili në fjalimin e tij mes tjerash theksoi rëndësinë e organizimit të pensionistëve. "Vitin e kaluar festuam 70 vjetorin



e organizimit të pensionistëve në Maqedoni, ndërsa këtë vit Shoqata juaj feston 60 vjetorin e

ekzistencës. Ky është jubileu i bukur dhe në të ardhmen do të kontribuoj për standard më të mirë

jetësor të pensionistëve dhe për mbledhje të përbashkëta argëtuese të personave të moshës së

tretë", tha ai.

Në manifestim u ndje era dhe shija e specialiteteve të ndryshme autentike të gatuar nga pensionistët, të cilat morën pjesë në takim, i cila me kalimin e viteve morri karakter humanitar pasi paratë nga ëmbëlsirat e shitura u dhuruan për qëllime humanitare. Ndryshe, për herë të parë këtë vit në këtë manifestim u ndanë shpërblime për ëmbëlsirat më të mira. Vending e parë e morën pensionistët e SHP Shtip dhe Karbinci, vending e dytë pensionistët nga Tetova, ndërsa vending e tretë pensionistët nga Lozova. Manifestimi u pasuroi me performancën e grupit muzikor i cili këndoi "Këngë për Mile Pop Jordanov" dhe këngën "Nalej, Nalej".